

101

TERMA NGA BANKINGU
QENDROR

PËRSE NA DUHET NJË FJALORTH I TILLË?

Materialet që flasin për veprimtarinë e një Banke Qendrore, përmbajnë terma dhe shprehje, që megjithëse mund të jenë ndeshur, nuk janë shumë familjare në jetën e përditshme. Duke qenë se shumëkush prej nesh kërkon të mësojë më në detaje, për botën e madhe dhe të larmishme të një banke qendrore dhe rolin e saj në ekonomi, një shpjegim i thjeshtë i disa prej termave më të përdorur në teknikën bankare, do ta ndihmonte të ishte gjithnjë e më pranë kësaj bote të ndërlikuar. Jo rrallë herë dëgjojmë të flitet për “paranë”, për “monedhën” dhe për “emisionin e monedhës” apo për “çmimet” dhe për “inflacionin” e të tjerë terma si këta, por jo gjithmonë jemi të qartë për mekanizmin që vepron brenda një banke qendrore dhe një ekonomie në tërësi dhe që i jep kuptimin praktik këtyre termave.

Ky fjalorth përbëhet prej rreth 100 fjalësh dhe shprehjesh. Ai përpiqet të shpjegojë disa nga termat e rëndësishëm duke vendosur lidhjet që ata kanë me funksionet e një banke qendrore. Në pjesën më të madhe të termave është sjellë si shembull Banka e Shqipërisë. Nuk mund të pretendohet që ky fjalorth të përfshijë gjithçka, ai shpjegon një pjesë të asaj që bëhet në gjirin e një banke qendrore. Nëse kërkonit të dini më shumë akoma, mbi monedhën, mbi bankat, mbi politikën monetare dhe mbi Bankën e Shqipërisë si institucion, mund të hulumtoni në broshurat informative që Banka e Shqipërisë, ia ka adresuar publikut të gjerë dhe në veçanti rrethit të teknikienëve ekonomistë, madje edhe në internet, në adresën www.bankofalbania.org.

MBI MËNYRËN E PËRDORIMIT.

Fjalorthi është i renditur sipas rendit alfabetik.

Nëse gjatë kërkimit të ndonjë fjale është dhënë referimi “shihni”, kjo do të thotë që fjala apo shprehja që ju kërkoni është shpjeguar në atë fjalë apo shprehje të treguar në referimin përkatës.

Shprehjet apo fjalët në kllapa gjatë shpjegimeve, kanë për qëllim të tregojnë lidhjen e ngushtë ndërmjet shpjegimit në fjalë dhe subjektit të vendosur në kllapa. Pra, ato lehtësojnë një kuptim më të gjerë të fjalës apo të shprehjes.



1. ACH (QENDRA E KRYQËZIMIT AUTOMATIK TË PAGESAVE).

ACH janë tre gërmat e para të emërtimit në gjuhën angleze të qendrës automatike të kryqëzimit të pagesave *Automatic Clearing House*. Në vetvete kjo qendër është një sistem elektronik i transferimit të fondeve nëpërmjet të cilit institucionet financiare kanë mundësi, që në mënyrë elektronike të kryqëzojnë hyrjet debitore dhe kreditore të llogarive bankare duke i netuar ato në përfundim.

2. ADMINISTRATORËT E BANKËS SË SHQIPËRISË.

Administratorët e Bankës së Shqipërisë janë: Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, 2 zëvendësguvernatorët dhe Inspektori i Përgjithshëm. Inspektori i Përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë emërohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për një afat pesëvjeçar. Ai drejton Departamentin e Kontrollit në Bankën e Shqipërisë, i cili ka për detyrë të kryejë kontrollin e brendshëm të të gjithë aktivitetit të Bankës së Shqipërisë. (shihni gjithashtu dhe *Banka e Shqipërisë, Këshilli Mbikëqyrës.*)

3. AGREGATËT MONETARË M1, M2, M3.

Sasia totale e instrumenteve të pagesës në një monedhë të dhënë mund të përcaktohet në mënyrë të ndryshme. Bazuar në shpejtësinë me të cilën format e ndryshme të parasë mund të përdoren për pagesa, ato mund të klasifikohen si agregati monetar M1, agregati monetar M2, agregati monetar M3. Agregati M1 përfshin paratë që përdoret në çdo kohë si mjet pagese - si: paratë në qarkullim dhe ato të depozituara nëpër banka në formën e llogarive korentë. Agregati M2 është i përbërë nga agregati M1

dhe depozitat me afat dhe të kursimit në lekë - depozitat e kursimit mund të konvertohen në mënyrë të thjeshtë e të shpejtë në para në dorë. Agregati M3 formohet nga M2 dhe depozitat në valutë.

4. ARI.

Dikur ari dhe metalet e tjera të çmuara janë përdorur si mjete pagese, kryesisht në formë monedhe. Me kalimin e kohës, për vetë faktin që është mall i rrallë, ari shërbeu si pikë referimi për monedhat e tjera dhe si mjet për të vendosur besimin tek monedha letër apo kartëmonedhat. Për shumë kohë, bankat qendrore ishin të detyruara të këmbenin, sipas kërkesës, kartëmonedhat e tyre me ar. Sot kjo mënyrë nuk praktikohet. Megjithatë, një numër vendesh, si për shembull, Zvicra vazhdojnë të mbajnë në ar një pjesë të rezervave të tyre valutore si një masë kujdesi kundrejt krizave të mundshme financiare.

5. BANKA BOTËRORE (BB).

Organizatë e themeluar në Breton Woods (SHBA) më 1944, në të njëjtën kohë me FMN. Banka Botërore është sot banka më e rëndësishme e ndihmës për zhvillim. Ajo ka për qëllim të përkrahë, përmes ndihmave financiare, zhvillimin e vendeve më të varfra dhe ngritjen e nivelit të tyre të jetesës. Shqipëria është anëtare e Bankës Botërore që nga viti 1991.

6. BANKA E RREGULLIMEVE NDËRKOMBËTARE (BIS BASEL).

Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare, që e ka selinë në Basel, ka filluar veprimtarinë e saj në vitin 1930. Ajo lehtëson bashkëpunimin midis bankave qendrore për të cilat kryen operacione të ndryshme bankare. Gjithashtu BIS Basel, shërben

si seli për disa komitete ndërkombëtare të rëndësishme, të cilat trajtojnë çështje specifike, që u përkasin bankave qendrore dhe bankave. Guvernatorët e bankave qendrore mbledhen rregullisht në BIS Basel, për të shkëmbyer informacione në lidhje me zhvillimet ekonomike ndërkombëtare dhe me aspekte të ndryshme të politikës monetare.

7. BANKA E SHQIPËRISË (BSH).

Banka e Shqipërisë është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë. Ky status sanksionohet në nenin 161 të Kushtetutës dhe me ligjin nr. 8269, datë 27.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i cili përcakton objektivat, detyrat, marrëdhëniet me sistemin bankar dhe me shtetin, organizimin dhe drejtimin, pronësinë mbi kapitalin, pasqyrat financiare dhe shpërndarjen e fitimit. Banka e Shqipërisë u krijua gjatë procesit të tranzicionit me kalimin në sistemin bankar dynivelor dhe me krijimin e hapësirës së nevojshme ligjore për një bankë qendrore, e cila u zyrtarizua me miratimin e ligjit nr. 7559 “Për Bankën e Shqipërisë”, datë 22 prill 1992. Banka e Shqipërisë është bankë me kapital tërësisht shtetëror dhe përgjigjet përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në cilësinë e autoritetit monetar e mbikëqyrës të vendit, Banka e Shqipërisë gëzon të gjitha funksionet e mirëfillta të një banke qendrore klasike: harton, miraton dhe zbaton politikën monetare të vendit, për realizimin e objektivave të së cilës ajo përdor instrumentet e duhura monetare; ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të

kartëmonedhës dhe të monedhës kombëtare; mban dhe administron rezervat valutore të Republikës së Shqipërisë; harton, miraton e zbaton regjimin e këmbimit valutor si dhe politikën e kursit të këmbimit; licencën ose revokon licencën për ushtrimin e veprimtarisë bankare si dhe mbikëqyr aktivitetin bankar me qëllim sigurimin e stabilitetit të sistemit bankar; shërben si bankier, këshilltar e agjent fiskal i Republikës së Shqipërisë; shërben si bankë e bankave të nivelit të dytë; nxit funksionimin normal të sistemit të pagesave. Ajo drejtohet nga një këshill, që quhet Këshilli Mbikëqyrës dhe që kryesohet nga Guvernatori. Guvernatori zgjidhet nga Kuvendi, me propozim të Presidentit të Republikës për shtatë vjet, me të drejtë rizgjedhjeje. Detyrat dhe veprimtaritë e saj bazohen në një ligj të veçantë, ligji mbi Bankën e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë e ka selinë e saj në Tiranë dhe ka pesë degë në rrethe të tjera të vendit: Shkodër, Elbasan, Korçë, Lushnjë dhe Gjirokastrë.

8. BANKA QENDRORE EVROPIANE (BQE).

BQE është autoriteti monetar (banka qendrore) i shteteve anëtare të Bashkimit Monetar Evropian. BQE e cila e ka selinë në Frankfurt mbi Main, drejton politikën monetare të Eurozonës. Këshilli Qeverisës është organi më i lartë vendimmarrës. Ai përbëhet nga 6 anëtarë të Bordit Ekzekutiv të BQE dhe nga guvernatorët e 12 bankave qendrore kombëtare të Eurozonës. BQE dhe 12 bankat qendrore kombëtare të Eurozonës, përbëjnë eurosistemin, ndërkohë që BQE dhe bankat qendrore të 15 shteteve anëtare të

9. BANKA QENDRORE.

Bashkimit Evropian, formojnë Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.

Termi “bankë qendrore” nënkupton një institucion qendror, që emeton monedhën dhe për rrjedhim rregullon dhe ofertën e parasë të vendit, duke luajtur kështu një rol kyç në trafikun e pagesave. Termi “institut i emetimit” thekson monopolin që banka qendrore, pra edhe Banka e Shqipërisë, ka për emetimin e kartëmonedhës.

10. BANKË, BANKË TREGTARE, BANKË E NIVELIT TË DYTË.

Bankat janë institucione që pranojnë depozitimin e fondeve të kursyera nga publiku dhe që akordojnë kredi. Veç funksionit ndërmjetësues midis depozituesve dhe huamarësve, bankat tregtare, krahas bankave qendrore dhe zyrave të Albapostës, në rastin e Shqipërisë, luajnë një rol të rëndësishëm në trafikun e pagesave pa para në dorë.

11. BAZA MONETARE.

Baza monetare njihet ndryshe edhe me emërtimin rezerva monetare apo paraja e fuqishme. Kjo, sepse ndryshimet e ndodhura te kjo e fundit shkaktojnë ndryshime në masën e parasë dhe të kreditit. Baza monetare përfshin parane në qarkullim të emetuar nga banka qendrore dhe llogaritë rrjedhëse të bankave.

12. BILANCI I PAGESAVE.

Bilanci i pagesave është një dokument statistikor i cili nënkupton regjistrimin kontabël të transaksioneve ndërkombëtare të një vendi me pjesën tjetër të botës gjatë një periudhe kohe të caktuar, zakonisht në një vit. Bilanci i pagesave

zakonisht ndahet në "llogari korente" dhe "llogari kapitale". Zërat kryesorë në llogarinë korente janë pagesat për importet dhe eksportet e mallrave dhe shërbimeve dhe në rastin tonë është dhe transferimi i pagesave në formën e të ardhurave nga emigrantët. Nga ana tjetër, në llogarinë kapitale regjistrohen shitjet dhe blerjet ndërkombëtare të aksioneve, të obligacioneve, të tokës etj.. Metodologjia ku mbështetet hartimi i statistikave të bilancit të pagesave është krijuar nga FMN-ja dhe njihet me emrin Manuali i Pestë i Bilancit të Pagesave.

13. BILANCI TREGTAR.

Bilanci tregtar përbën një nga kategorizimet kryesore të statistikave të bilancit të pagesave. Ai tregon diferencën midis totalit të eksporteve me totalin e importeve të regjistruara të një vendi për një periudhë kohe të caktuar. Zakonisht në literaturë flitet për bilancin tregtar të mallrave dhe të shërbimeve, megjithëse në përputhje me metodologjinë që përdoret për regjistrimin dhe raportimin e statistikave të bilancit të pagesave, bilanci tregtar është i llogaritur në mënyrë të veçantë si për mallrat ashtu dhe për shërbimet. Zhvillimet në tregtinë e jashtme të një vendi janë të rëndësishme nga këndvështrimi i ekuilibrit të jashtëm të vendit. Në Shqipëri vëllimi i importeve zë rreth 80 për qind të vëllimit të tregtisë së jashtme, duke bërë kështu që për një periudhë të gjatë kohe bilanci tregtar të jetë në nivele të larta.

14. BONO THESARI.

Një detyrim borxhi i negociueshëm i emetuar nga Ministria e Financave, i cili ka afat maturimi jo

më të gjatë se një vit. Meqënëse është një detyrim i marrë nga qeveria, bonot e thesarit konsiderohen me rrezik zero. Në vendin tonë bonot e thesarit emetohen çdo javë me anë të ankandeve që organizohen nga ana e Bankës së Shqipërisë.

15. BORD I MONEDHËS.

Një mënyrë e të bërit politikë monetare ku banka qendrore merr angazhimin që do të rrisë ofertën e parasë për atë shumë që korrespondon me kundërvleftën e shumës me të cilën shtohet rezerva e saj valutore.

16. BRETTON WOODS.

Në muajin korrik të vitit 1994 në hotelin "Mount Washington" në Bretton Woods, të shtetit New Hampshire u mbajt Konferenca Monetare dhe Financiare e Kombeve të Bashkuara. Marrëveshja që u arrit në këtë konferencë ishte shumë e rëndësishme, pasi ajo vendosi kuadrin, i cili administroi sistemin ndërkombëtar të pagesave gjatë 25 viteve pas Luftës së Dytë Botërore dhe themeloi dy institucione financiare të rëndësishme: Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore, të cilat ekzistojnë dhe sot. (shihni gjithashtu dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.)

17. BUXHETI, DEFICITI BUXHETOR.

Deklarata e pozicionit të planifikuar financiar të qeverisë për një periudhë të caktuar kohe, zakonisht 1 vit, e cila bazohet mbi vlerësimet e bëra nga qeveria në lidhje me shpenzimet që ajo do të kryejë (paga dhe shpërblime mbi to, blerje e mallrave të ndryshëm, pagesa të interesave, investimeve në sistemin rrugor, sistemet ujtëse,

në spitale, shkolla etj., etj..) në përputhje me vlerësimet për shumën e të ardhurave (të ardhurat nga tatimet, doganat etj..) që do të realizohen nga burime të ndryshme, që do të jenë të vlefshme për të mbuluar shpenzimet. Një buxhet është i balancuar kur ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisë nuk ka ndryshime, pra kur këto grupe të mëdha të buxhetit janë të barabarta. Kur të ardhurat janë më të ulëta /më të larta se sa shpenzimet, jemi në kushtet e një deficiti/suficiti buxhetor. Në mënyrë thelbësore, deficiti/suficiti buxhetor varet nga aktiviteti ekonomik, sepse është ai që krijon bazën reale të vjeljes së të ardhurave.

18. CASH FLOW.

Një mënyrë e të maturit të shëndetit financiar të kompanisë. Qëllimi i tij është barazimi i të hyrave në formë cash-i me pagesat po në cash, në një periudhë të dhënë kohe.

19. CIKLI I BIZNESIT.

Luhatje periodike, të komponentëve të aktivitetit të përgjithshëm ekonomik. Zakonisht ato përkufizohen si devijime të prodhimit (Produktit të Brendshëm Bruto të shprehur me çmime konstante) nga prija afatgjatë e tij. Në qoftë se cikli është në fazën e gjallërimit, rritja ekonomike pritet të jetë në përputhje me kapacitetet prodhuese disponibël të vendit. Në fazën e kulmimit situata përkon me një rritje ekonomike të shpejtë. Në fazën që vijon, atë të rënies, prodhimi bie dhe kapacitetet prodhuese mbeten të pashfrytëzuara. Për rrjedhim, papunësia rritet dhe ekziston rreziku i deflacionit.

20. ÇMIMI.

Raporti i këmbimit midis mallrave të ndryshëm, i matur në njësi monetare (shihni gjithashtu dhe monedhë, nivel çmimesh, interes).

21. DEFICITI TREGTAR.

Bilanci tregtar negativ, domethënë diferenca negative ndërmjet eksporteve dhe importeve të regjistruara njihet si deficit tregtar i vendit. E kundërta, domethënë diferenca pozitive ndërmjet eksporteve dhe importeve të regjistruara njihet si suficit në bilancin tregtar të vendit. (shihni gjithashtu dhe bilanci tregtar)

22. DEFLACIONI.

Deflacioni i referohet një situatë kur niveli i çmimeve të konsumit, demonstroi rënie përgjatë

një periudhe kohore. Deflacioni është rasti i kundërt i inflacionit. (shihni gjithashtu dhe indeksi i çmimeve të konsumit)

23. DEPOZITA KURSIMI.

Fonde që individë apo ndërmarrje depozitojnë pranë një banke, më shpesh në formën e një llogarie kursimi që përfiton interesa.

24. DEPOZITA ME AFAT.

Fonde që janë depozituar në një bankë për një periudhë kohe të fiksuar. Zakonisht, investuesi nuk mund të tërheqë shumën e depozituar deri në përfundim të afatit të maturimit. (shihni gjithashtu dhe maturim)

25. DEPOZITA PA AFAT
APO LLOGARI
RRJEDHËSE.

Fonde, që mund të transferohen, në çdo kohë dhe pa kufizim nga një llogari bankare në një tjetër llogari ose të konvertohen me para në dorë.

26. DEPOZITA
NJËDITORE.

Është një lehtësi e Bankës së Shqipërisë që i mundëson bankave të depozitojnë për një ditë, likuiditetin e tepërt të tyre në para, pranë Bankës së Shqipërisë. Për këtë investim bankat marrin interesa.

27. EURO.

Monedhë e përbashkët e 12 vendeve, pjesëmarrëse në bashkimin ekonomik dhe monetar evropian. Një euro është e ndarë apo përbëhet nga 100 cent. Euro është hedhur në përdorim në 1 janar 1999. Që nga kjo datë, përgjegjësia për politikën monetare të Zonës Euro, i është besuar Bankës Qendrore Evropiane. Megjithatë, prania fizike e euros u bë më 1 janar 2002.

28. FITIMI BRUTO I
BANKËS QENDRORE.

Fitimi bruto, në rastin e Bankës së Shqipërisë, llogaritet duke zbritur nga të ardhurat, shpezimet e bëra për vitin financiar.

29. FITIMI NETO I
BANKËS QENDRORE.

Fitimi neto, në rastin e Bankës së Shqipërisë, rezulton pas zbritjes nga fitimi bruto i: borxheve të dyshimta pa shpresë arkëtimi (kthimi); masës së zhvlerësimit të mjeteve në bilancin e Bankës së Shqipërisë; shpenzimeve të tjera rezervë dhe të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, që konsiderohen të nevojshme për Bankën e Shqipërisë.

30. FONDI MONETAR
NDËRKOMBËTAR (FMN).

FMN, është një organizatë ndërkombetare, që ka për synim të zbatojë bashkëpunimin monetar dhe ekonomik midis shteteve anëtare. Shqipëria është anëtare e këtij organizmi të rëndësishëm që nga viti 1991. FMN është themeluar në vitin 1944 në Breton Woods në të njëjtën kohë me Bankën Botërore. Ai ka selinë e tij në Washington. Në periudha të rregullta kohore, FMN organizon takime në të cilat shqyrtohen politikat monetare dhe ekonomike të ndjekura nga shtetet anëtare të tij. Në varësi të ndjekjes së politikave monetare dhe ekonomike në përputhje me standardet ndërkombëtare, përcaktohen masa dhe burimet e ndihmave financiare për vendet në vështirësi ekonomike.

31. FOREX.

Shkurtim i tregut ndërkombëtar të këmbimeve valutore.

32. FUQIA BLERËSE E
MONEDHËS.

Fuqia blerëse e parasë, tregon sasinë e mallrave, që është e mundur të blihen me një shumë të caktuar parash. Kur niveli i çmimeve rritet, fuqia

blerëse e parasë ulet dhe sasia e mallrave që mund të blihet me një shumë të caktuar parash pakësohet (inflacioni). Në rastin e kundërt do të kishim një fuqi blerëse të monedhës që rritet, kur çmimet ulen (deflacion). Qëllimi i politikës monetare është mbajtja e një fuqie blerëse të monedhës sa më të stabilizuar, duke “dozuar” furnizimin me para të ekonomisë.

33. GRUPI I TË SHTATËVE - G7.

Grupi i shtatë ekonomive industriale kryesore përbëhet nga (Kanada, Francë, Gjermani, Itali, Japoni, Mbretëri e Bashkuar dhe SHBA). Kryeministrat apo ministrat e ekonomisë së këtyre vendeve takohen në mënyrë periodike për të diskutuar marrëdhëniet politike, ekonomike, monetare dhe financiare në planin ndërkombëtar.

34. GJENDJA MONETARE.

Është paraqitja e treguesve monetarë, në mënyrë të sintetizuar nga konsolidimi i bilanceve të bankave tregtare dhe bilancit të Bankës së Shqipërisë. Gjendja monetare siguron informacionin e nevojshëm për formulimin, zbatimin dhe monitorimin e politikës monetare. Përpunimi i të dhënave bëhet në bazë të metodikës së hartimit të gjendjes monetare.

35. INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT - IÇK.

Indeksi, që mat ecurinë mesatare të çmimeve të mallrave dhe të shërbimeve që bëjnë pjesë në shportën shqiptare të konsumit. Ajo vlerësohet si përfaqësuesja më e mirë e mënyrës së konsumit të mallrave më të përdorshëm nga një familje mesatare në Shqipëri. Përcaktimi i shportës kalon nëpër një proces të tërë vrojtues dhe vlerësues, të bazuar mbi një metodologji statistikore të plotë sipas standardeve ndërkombëtare. Në Shqipëri, indeksi i çmimeve të konsumit, që shpesh quhet indeksi i çmimeve, shërben për të matur inflacionin (shihni gjithashtu dhe - indeksi i çmimeve).

36. INDEKSI I ÇMIMEVE.

Treguesi që mat ndryshimin në përqindje të lëvizjes së çmimit të një malli apo të një grupi mallrash dhe shërbimesh, njihet me emërtimin indeks çmimesh. Indeksi i çmimeve të konsumit është një nga treguesit më të ndeshur. Ai luan një rol kryesor në sjelljen dhe zbatimin e politikës monetare të bankave qendrore në përgjithësi, dhe të Bankës së Shqipërisë në veçanti. Banka e Shqipërisë kujdeset për stabilitetin e çmimeve të konsumit. INSTAT, llogarit edhe një numër indeksesh të tjera çmimesh, të cilat masin: ecurinë e çmimeve të prodhimit (IÇP), ecurinë e çmimeve në sektorin e ndërtimit apo indeksin e kushtimit në ndërtim (IKN); ecurinë e pagave nëpërmjet indeksit të pagave në sektorin publik.

37. INDEKSIMI.

Indeksimi është një mekanizëm që shërben për rregullimin e vlerës së një kontrate në aspektin monetar, me qëllim përshtatjen e saj me lëvizjet e çmimeve. Kryerja e indeksimit, ruan në njëfarë

38. INFLACIONI I PRITSHËM.

mënyre vlerën reale të kontratës. Kjo është më e shprehur në kontratat e pagave. Kjo do të thotë që ato mund të rriten në mënyrë periodike në përgjigje të shifrave të rritura të inflacionit.

Norma e inflacionit që pritet të jetë në të ardhmen, përbën normën e pritshme të inflacionit. Në një situatë hipotetike, në të cilën norma aktuale e inflacionit është e barabartë me normën e pritshme, thuhet se inflacioni i faktuar ka kapur në mënyrë perfekte vlerat e inflacionit të pritshëm apo të atij që pritej. Në realitet, nuk ndodh kështu, pra rasti perfekt ndeshet rrallë. Debati ekziston në faktin se si të modelohet më mirë mënyra si agjentët ekonomikë formojnë pritjet për inflacionin. (shihni gjithashtu dhe parashikimi i inflacionit)

39. INFLACIONI.

Në qoftë se niveli i përgjithshëm i çmimeve rritet edhe kur fuqia blerëse e monedhës bie, atëherë thuhet se ka inflacion. Pra me të njëjtën sasi parash, nuk mund të blejmë të njëjtën sasi mallrash, por më pak se sa periudha që i referohemi. E tëra kjo ndodh, sepse çmimet janë rritur. Indeksi i çmimeve të konsumit, mundëson matjen e inflacionit në vend. Inflacioni shpreh rritjen në përqindje të indeksit të çmimeve të konsumit. Rasti i kundërt i inflacionit është deflacioni. (shihni gjithashtu dhe indeksi i çmimeve të konsumit)

40. INFORMACIONI ASIMETRIK.

Informacioni asimetric ndodh kur palët në treg zotërojnë informacione të ndryshme në lidhje me mallin apo me shërbimin që tregtohet. Tregu i punës është

një shembull i mirë i tregut ku dominon informacioni asimetrik. Për shembull, aplikuesit ose ata që kërkojnë një vend pune, kanë më shumë informacion në lidhje me aftësitë e tyre, me ndershmerinë dhe me angazhimin sesa punëmarrësit e tyre të mundshëm. Informacioni asimetrik është një nga arsyet përse firmat mund të ofrojnë paga më të larta, jo vetëm për të tërhequr kandidatët më të mirë apo më produktivë, por gjithashtu dhe për të frenuar largimin e personelit më produktiv dhe më cilësor.

41. INSTITUCION FINANCIAR.

Institucioni, i cili grumbullon fonde nga publiku dhe i vendos ato në aktive financiare, të tilla si depozita, kredi, obligacione etj., gjithsesi të ndryshme nga pasuritë e paluajtshme.

42. INSTITUTI I EMETIMIT.

Me anë të këtij kuptohet institucioni që gëzon monopolin e emetimit të kartëmonedhës dhe të monedhës metalike. Në shumicën e vendeve ky privilegj i përket bankave qendrore. Edhe në Shqipëri këtë pozicion e gëzon Banka e Shqipërisë.

43. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE.

Tërësia e transaksioneve me anë të të cilave bankat qendrore influencojnë paranë dhe nivelin e përqindjeve të interesit në tregun e parasë, njihet si instrumente të politikës monetare. Si të tillë, Banka e Shqipërisë përdor, kryesisht repo, kredi njëditore, depozitë njëditore, kredi lombard, operacionet e tregut të hapur, rezervën e detyruar, shitblerjet me të drejta të plota.

44. KARTËMONEDHA NË QARKULLIM.

Shuma e të gjitha kartëmonedhave bankare të emetuara nga një bankë qendrore dhe ajo që është në qarkullim për një kohë të caktuar (në një moment të dhënë), përbën kartëmonedhën në qarkullim.

45. KËSHILLI MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË.

Këshilli Mbikëqyrës është organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i politikave, i administrimit dhe i operacioneve të Bankës së Shqipërisë. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 9 anëtarë, si më poshtë: Guvernatori i Bankës së Shqipërisë që është edhe Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës; Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës së Shqipërisë; Zëvendësguvernatori i Dytë i Bankës së Shqipërisë; dhe 6 anëtarë. Të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, mbështetur në propozimet:

- Guvernatori i Bankës së Shqipërisë propozohet nga Presidenti i Republikës;
- 4 anëtarë propozohen nga Kuvendi;
- 3 anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministrave i Qeverisë së Shqipërisë;
- 1 anëtar propozohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

Zëvendësguvernatorët zgjidhen dhe emërohen nga Këshilli Mbikëqyrës me propozim të Guvernatorit.

46. KREDIA NJËDITORE.

Është një lehtësi e Bankës së Shqipërisë që përdoret për t'i ardhur në ndihmë bankave të nivelit të dytë duke i furnizuar ato me likuiditete,

në rastet kur ato për arsye të ndryshme nuk kanë fonde të nevojshme për të përmbushur të gjitha premtimet për pagesa në një ditë pune ndaj klientëve të tyre.

47. KREDIA PËR
QEVERINË.

Të gjitha letrat me vlerë të Qeverisë që zotëron Banka e Shqipërisë në një moment të caktuar njihen si kredi për qeverinë.

48. KREDIA PËR
EKONOMINË.

Përfshin të gjitha pretendimet e bankave ndaj ndërmarrjeve të sektorit publik, ndaj ndërmarrjeve private, ndaj individëve dhe ndaj institucioneve financiare. Këto pretendime janë të shprehura në formën e kredive të pastra.

49. KREDIA LOMBARD,
PËRQINDJA LOMBARD.

Kredia lombard është instrument borxhi ose një hua e garantuar me letra me vlerë që banka qendrore, në rastin tonë, Banka e Shqipërisë, u akordon bankave të nivelit të dytë. Ajo ka për qëllim të ndihmojë këto të fundit për kapërcimin e problemeve të përkohshme me likuiditetin. Banka qendrore, e akordon atë mbi bazën e një kolaterali. Ajo përfaqëson mundësinë e fundit kredituese për bankat dhe kjo e bën atë më të shtrenjtë, pra me përqindjen e normës së interesit më të lartë në treg. Përqindja e interesit e kësaj kredie quhet, gjithashtu, përqindje lombard.

50. KRIJIMI I PARASË.

Bankat krijojnë para të re duke dhënë kredi. Aftësia e tyre për të krijuar para është e ndikuar nga rezervat e detyruara dhe nga tendenca e politikës monetare (konservatore, neutrale apo zbutëse) në momentin e dhënë të kohës.

51. *KURSI I KËMBIMIT.*

Kursi i këmbimit është çmimi i një monedhe i shprehur në njësi të një monedhe tjetër. Shumë shpesh, në rastin e Shqipërisë, dëgjojmë të flitet për atë kurs këmbimi që tregon sasinë e monedhës sonë kombëtare (lekë), që duhet dhënë për të marrë një njësi të një monedhe të huaj. Kështu, nëse themi që kursi i këmbimit sot është 130 lekë/euro, do të thotë që për një euro duhen paguar 130 lekë, pra që çmimi i euros është 130 lekë. Nëse nesër ai do të jetë 132 lekë/euro, atëherë themi se çmimi për një euro është rritur ose që monedha evropiane (euro) është mbiçmuar (forcuar, mbivlerësuar), ose që leku është nënçmuar (dobësuar, nënvlerësuar) në krahasim me një ditë më parë. Nëse kursi i këmbimit do të jetë jo më 130 apo 132, por 128 lekë/euro, atëherë jemi në rastin e kundërt, kur leku është forcuar ndërkohë që euro është dobësuar, apo është blerë më lirë se një ditë më parë.

52. *LETRA ME VLERË.*

Instrumente financiare të cilat mishërojnë të drejta pronësie apo njohje borxhi. Aksionet dhe obligacionet janë kategoritë më të rëndësishme të letrave me vlerë që negociohen në tregun e kapitaleve.

53. *LIBOR.*

LIBOR është bashkim i inicialeve apo akronimi i togfjalëshit: London Interbank Offered Rate (norma e interesit e ofruar në tregun ndërbankar të Londrës). LIBOR-i është një normë interesi me të cilën, bankat tregtare në Londër, marrin hua nga njëra-tjetra. Çdo ditë pune, në orën 11.00 (me orën e Londrës) bankat më të rëndësishme që

veprojnë në planin ndërkombëtar i njoftojnë Shoqërisë së Bankierëve Britanikë në Londër, përqindjet e interesit për fondet që ato kanë marrë në treg, nga banka të tjera apo për ofertat e marra nga bankat e tjera. LIBOR shpesh përdoret si normë interesi referuese, për shembull në kontratat hipotekare.

54. LIGJI "PËR BANKAT
NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË".

Ligji nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", formon bazën ligjore për të ushtruar veprimtari bankare në Shqipëri. Ai përcakton kushtet që duhen plotësuar për të hapur një bankë, cakton veprimtaritë që ajo mund të kryejë; fondet e saj; rezervat në likuiditete. Nga ana tjetër, ligji për bankat, përcakton bazën ligjore për atë që ka të drejtën e ushtrimit të mbikëqyrjes së veprimtarisë bankare në Shqipëri.

55. LIGJI "PËR BANKËN E
SHQIPËRISË".

Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" së bashku me nenin 161 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përbëjnë kuadrin ligjor, që rregullon aktivitetin e Bankës së Shqipërisë. Në ligj përcaktohet qartë fakti që Banka e Shqipërisë është person juridik publik, me qendër në Tiranë. Ajo është e pavarur nga çdo pushtet tjetër, për realizimin e objektivit kryesor të veprimtarisë së saj, arritjen e stabilitetit të çmimeve. Çdo detyrë tjetër kushtëzohet nga arritja e objektivit kryesor.

56. LIKUIDITETI.

Mjete pagese të disponueshme për të kryer pagesa në mënyrë të menjëhershme apo lehtësia dhe shpejtësia me të cilën një aktiv apo edhe aset

mund të konvertohet në *cash* pa humbje, shpjegon më mirë termin e të qenit likuid apo të likuiditetit. Likuiditetet e bankave përbëhen kryesisht nga aktivet si llogari rrjedhëse në Bankën e Shqipërisë. Duke zbatuar instrumentet e politikës së saj monetare, Banka e Shqipërisë, ndikon mbi likuiditetet e bankave, nëpërmjet përqindjeve të interesit të aplikuara në tregun e parasë .

57. LLOGARITË
RRJEDHËSE TË
BANKAVE.

Gjendja kreditore në llogaritë rrjedhëse që bankat mbajnë në bankën qendrore, në rastin tonë në Bankën e Shqipërisë. Këto teprica përbëjnë një pjesë të rëndësishme të likuiditetit të sistemit bankar, i cili tregtohet në tregun e parasë. Banka qendrore, ndikon mbi tepricat e llogarive rrjedhëse që bankat kanë pranë saj, duke ndryshuar përqindjen e interesit të cilën ajo aplikon në kreditimin e bankave (shihni gjithashtu dhe instrumentet e politikës monetare).

58. MEKANIZMI I
TRANSMISIONIT I
POLITIKËS MONETARE.

Një politikë monetare rezulton efiçente nëse vendimet e marra për ndryshimin e qëndrimit (në lidhje me ndryshimin e normave të interesit), përcillen në kohën e duhur në ekonomi. E tërë rruga që përshkon vendimi politik, i ngjan një skeme, të themi si ato të shpërndarjes së energjisë elektrike, që në gjuhën bankare njihet si skemë e transmisionit të politikës monetare. Secila pjesë e kësaj skeme luan rolin e vet në vendimpërcjellje apo në thithjen e sinjaleve që banka qendrore lëshon, për arritjen e objektivit final për të cilin përgjigjet. Nëse marrim rastin e Shqipërisë, një skemë do të kishte kanalet e saj të transmisionit që mund të jenë: kanali i kredisë, i përqindjeve të interesit, i kursit të këmbimit, i qeverisë e shumë e shumë kanale të tjera, ndikimi i të cilave finalizohet tek një vlerë e parashikuar për inflacionin. Skema materializohet në një kombinim faktorësh të vendosur në një model makroekonomik, që përpiqet të kapë sa më shumë informacion nga ekonomia e vendit. Njohja e kanaleve të transmisionit të politikës monetare është një prej parakushteve për adoptimin e regjimit të targetimit të inflacionit dhe një nga sfidat për politikën monetare të Bankës së Shqipërisë.

59. MONOPOLI I
EMETIMIT.

E drejta ekskluzive e një institucioni për të emetuar para, përbën monopolin e emetimit. Në Shqipëri, monopoli për të emetuar para i përket Bankës së Shqipërisë dhe kjo është e sanksionuar me ligj. Institutet e emetimit të Eurozonës, e kanë transferuar në Bankën

Qendrore Evropiane të drejtën e monopolit të tyre të mëparshëm, që i autorizonte për të emetuar para në monedhën e tyre kombëtare.

60. NIVELI I ÇMIMEVE.

Niveli mesatar i të gjitha çmimeve të mallrave e të shërbimeve në një ekonomi në një moment të caktuar. Një ngritje e nivelit të çmimeve ka për pasojë një ulje të fuqisë blerëse të monedhës. Ndryshimet e nivelit të çmimeve maten me ndihmën e indekseve të çmimit. Për të zbatuar një politikë monetare të përshtatshme, Banka e Shqipërisë mban parasysh ecurinë e çmimeve të konsumit. (Shihni gjithashtu dhe indeksi i çmimeve të konsumit, inflacioni, indeksi i çmimeve.)

61. NORMA MUJORE E INFLACIONIT.

Norma mujore e inflacionit përfaqëson, ndryshimin në përqindje të indeksit të çmimeve të konsumit të muajit 't' në krahasim me një muaj më parë 't-1'.

62. NORMA REALE E INTERESIT.

Ashtu si dhe tregues të tjerë, për të kuptuar rolin e vërtetë të përqindjes së interesit është e nevojshme që ai të "pastrohet" nga efektet zhvlerësuese në ekonomi, duke fituar kështu normën reale të interesit. Zakonisht, si faktor zhvlerësimi përdoret inflacioni i matur si ndryshim në përqindje të indeksit të çmimeve të konsumit.

63. NORMA VJETORE E INFLACIONIT.

Norma vjetore e inflacionit përfaqëson, ndryshimin në përqindje të indeksit të çmimeve të konsumit të muajit 't', në krahasim me 12 muaj ose një vit më parë, 't-12'. Norma vjetore e

inflacionit, ashtu si edhe normat e tjera të tij, ndiqet me kujdes nga Banka e Shqipërisë, përsa kohë që si objektivi i dëshiruar i saj është arritja e një norme vjetore të inflacionit të fundvitit brenda kufijve 2 – 4 për qind.

64. OBJEKTIVAT E POLITIKËS MONETARE.

Çdo regjim i politikës monetare në mënyrë të qartë fikson një qëllim final për të arritur. Literatura e shumë tregon se qëllimi (objektivi) final i politikës monetare, në përgjithësi, është kontrolli mbi çmimet. Megjithatë, po literatura përmend raste kur rolin e objektivit final e luan edhe rritja ekonomike, punësimi, ekuilibri i jashtëm i vendit etj.. Pavarësisht nëse objektivi përfundimtar i politikës monetare do të jetë vetëm stabiliteti i çmimeve apo do të ketë dhe objektiva të tjerë, duhet theksuar se suksesi final arrihet falë përzgjedhjes së një objektivi të ndërmjetëm (forma e objektivit të ndërmjetëm përcakton edhe llojin e regjimit të politikës monetare), realizimi i të cilit përbën kontribuesin kryesor në përmbushjen e objektivave finalë. Në ndryshim nga objektivat finalë, objektivat e ndërmjetëm janë variabla makroekonomikë, të cilët në një mënyrë ose në një tjetër janë nën kontroll të drejtpërdrejtë të bankave qendrore si për shembull, baza monetare, kursi i këmbimit, përqindja e interesit etj..

65. OFERTA E PARASË.

Që një ekonomi të funksionojë, duhet të ketë para dhe që të ketë para, ajo duhet të furnizohet në vijimësi me këto të fundit. Sasia e parasë në ekonomi duhet të jetë e mjaftueshme, pra të mos

66. ORGANIZATA PËR
BASHKËPUNIM DHE
ZHVILLIM EKONOMIK -
OECD.

67. PARAJA FIZIKE
(CASH).

68. PARAJA MAGNETIKE
(KARTAT MAGNETIKE).

ketë as sasi të tepërt, por as të mungojë. Kjo bëhet për të evituar rrezikun e një inflacioni ose të një deflacioni (politika monetare). Administrimi i ofertës së parasë bëhet nëpërmjet sistemit bankar. Banka qendrore furnizon bankat e tjera me monedhë ose me likuiditete dhe këtë, ajo e bën duke vënë në përdorim instrumentet e politikës së saj monetare. Më tej, paraja kalon nga sistemi bankar drejt pjesës tjetër të ekonomisë nëpërmjet procesit të krijimit të parasë.

Organizata është themeluar në vitin 1960 nga vendet evropiane të industrializuara, SHBA dhe Turqia, me qëllim për të rritur ekonominë, punësimin dhe nivelin e jetesës në vendet anëtare si edhe për të kontribuar në një zhvillim të shëndetshëm të ekonomisë botërore e të tregtisë ndërkombëtare. OECD e ka selinë e saj në Paris.

Kartëmonedhat dhe monedhat metalike. *Cash*— i i hedhur në qarkullim nga institutet e emetimit ose nga bankat qendrore dhe që publiku e përdor çdo ditë, nuk është gjë tjetër veçse paraja që ne shohim dhe prekim. Ajo përdoret veçanërisht në transaksionet (shitblerjet) e përditshme, në shumata të vogla.

Paraja fizike, sot është zëvendësuar në pjesën më të madhe të vendeve, në një formë tjetër, në atë të parasë magnetike apo të konvertueshme nëpërmjet kartave magnetike. Në këtë mënyrë përdorimi i *cash*-it, është reduktuar ndjeshëm. Duke kryer veprimet me anë të kartave të tilla,

69. PARAJA NË
QARKULLIM.

pjesëmarrja e sistemit bankar në ekonomi rritet ndjeshëm, paraja lëviz në mënyrë të padukshme në kanalet e sistemit bankar, ajo evidentohet atje, koha e përdoruesve të kartave kursehet, rritet siguria për ruajtjen e parave.

Shuma e të gjithë monedhës (kartëmonedhat dhe monedhat metalike) së emetuar nga banka qendrore që është në qarkullim në një moment të caktuar kohe.

70. PARAJA.

Instrument pagese dhe këmbimi, pranuar si e tillë nga publiku. Paraja, shërben gjithashtu, si rezervë vlere dhe njësi llogarie. Ajo mund të paraqitet në forma të shumta. Ajo që ka rëndësi është se për të fituar besimin e përgjithshëm të popullatës ajo duhet të jetë e rallë në mënyrë të përshtatshme.

71. PARASHIKIMI I
INFLACIONIT.

Parashikimi i inflacionit është një proces gjatë të cilit, merret parasysh një kuadër i gjerë faktorësh ekonomikë dhe koniukturalë të periudhës që ka kaluar si edhe pritjet për to për periudhat e ardhme. Zakonisht aplikohen modele mjaft komplekse, rezultat i të cilave është një vlerë apo një interval vlerash për inflacionin, që parashikohet të faktohet në një të ardhme afatshkurtër, afatmesme apo edhe afatgjatë. Parashikimi i inflacionit luan një rol thelbësor në vendimmarrjen e një banke qendrore. Politika monetare dhe ndryshimi i qëndrimit të saj bazohet mbi parashikimin për inflacionin. Por jo vetëm kaq, edhe agjentët e tjerë të ekonomisë, biznesi, investitorët, konsumatorët etj., janë

shumë të interesuar për shifrat e ardhme të inflacionit. Edhe këta të fundit ndërtojnë strategjitë e tyre në nivel mikroekonomik. Bankat qendrore që zbatojnë regjime të inflacionit të synuar (Inflation Targeting), si Banka e Anglisë, Rezerva Federale e Zelandës së Re etj., parashikojnë inflacionin për periudha minimalisht njëvjeçare dhe i bëjnë publike rezultatet e këtij parashikimi. Qëndrimi i politikës monetare ngrihet mbi bazën e këtyre parashikimeve. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë, ndërtohet, gjithashtu, mbi bazën e parashikimeve për inflacionin, duke argumentuar kështu qëndrimin e saj gjatë procesit të vendimmarrjes. Nëse inflacioni i pritshëm prek stabilitetin e çmimeve, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë rishqyrton politikën e saj monetare.

72. PAVARËSIA E BANKËS QENDRORE.

Ky term i referohet, kryesisht, marrëdhënies midis bankës qendrore dhe autoriteteve politike. Pavarësi do të thotë, që një bankë qendrore të mund të marrë vetë vendimet e saj të politikës monetare, në përputhje me objektivat strategjike të zhvillimit makroekonomik të vendit, në asnjë rast nën ndikimin e qeverisë ose të parlamentit. Për këtë qëllim legjislacioni përkatës që rregullon veprimtarinë e bankës qendrore është i veçantë. Dhënia e hapësirave të nevojshme ligjore është një parakusht që banka qendrore duhet të përmbushë, për të hedhur hapa të sigurt në kryerjen e misionit të saj. Një bankë qendrore e pavarur, arrin të sigurojë zbatimin e një politike monetare, larg “lojës” dhe interesave politikë

afatshkurtër. Faktet kanë treguar se vendet e zhvilluara, me banka qendrore të pavarura, kanë arritur të kenë një stabilitet të lartë të çmimeve. Pavarësia e bankës qendrore matet nga tregues të ndryshëm sasiore. Pavarësia ligjore dhe ajo reale janë dy përmasat themelore mbi të cilat duhet të ngrihet institucioni i pavarësisë së një banke qendrore. Në rastin e Bankës së Shqipërisë, është konkluduar se banka jonë qendrore gëzon një pavarësi ligjore të konsiderueshme në kufij të kënaqshëm, ndërkohë që pavarësia e saj reale është në nivele më të ulëta, ndonëse tendenca e kësaj të fundit ka ardhur duke u forcuar.

73. PËRGJEGJSHMËRIA
DHE TRANSPARENCA E
BANKËS QENDRORE.

Në kuptimin e përgjithshëm përgjegjshmëri do të thotë që politikëbërësit, duhet dhe japin llogari për arritjen e objektivave për të cilët ata duhet të kujdesen. Me fjalë të tjera, politikëbërësit duhet të konsiderohen përgjegjës, për faktin se sa afër janë treguesit e faktuar ekonomikë me vlerat e synuara të vendosura si objektiva. Në një shoqëri demokratike, parlamenti përfaqëson pikëpamjet dhe vullnetin e zgjedhësve. Prandaj është thelbësore që banka qendrore të përgjigjet drejtpërdrejt para parlamentit. Në mënyrë që llogaridhënia të jetë e plotë ajo duhet të: (1) shpjegojë vendimmarrjen në lidhje me objektivat finalë të politikës monetare; (2) sigurojë standard të lartë transparence të politikës monetare të ndjekur; (3) nxjerrë përgjegjësitë përfundimtare në lidhje me politikën monetare të ndjekur. Transparenca përbën një nga elementet qendrore

të përgjegjshmërisë demokratike. Informacioni në lidhje me sjelljen e bankës qendrore është thelbësor për vlerësimin e performancës së saj dhe ritjen e besueshmërisë së institucionit para publikut. Pa këtë informacion është e pamundur të jepet një gjykim i shëndoshë nëse banka i ka përmbushur detyrat e saj.

74. PËRQINDJE E REPOVE.

Përqindje interesi me të cilën Banka e Shqipërisë përfundon marrëveshjet e riblerjes me bankat.

75. PËRQINDJE INTERESI.

Çmimi që paguhet për përdorimin e një shume parash në një periudhë kohore të caktuar. Interesi paguhet nga debitori për te kreditori. Ai shprehet në përqindje të shumës së dhënë hua (përqindje e interesit) dhe, në përgjithësi, i referohet një periudhe njëvjeçare.

76. POLITIKA FISKALE.

Pjesa e politikës qeveritare, e cila synon ritjen e të ardhurave nëpërmjet taksimit dhe përcaktimin e shumave dhe të qëllimit të shpenzimeve qeveritare. Një nga teoritë më të shquara ajo Kejnsianiste, argumenton se politika fiskale është një mjet i mirë për të stabilizuar ciklet e biznesit. Kur ekonomia është drejt rënies, atëherë politika fiskale do të konsiderohej e përshtatshme apo ekspansioniste, nëse do të rriteshin shpenzimet që nxisin prodhimin dhe në të njëjtën kohë do të uleshin taksat. Ulja e taksave do t'u linte më shumë hapësira dhe burime investimesh bizneseve. Ndërkohë që gjatë periudhës së inflacionit të lartë, politika fiskale duhet të koordinojë më shumë se kurrë me politikën

monetare. Në këtë periudhë, politika fiskale duhet të ndërmarrë masa shtrënguese që kufizojnë shpenzimet buxhetore, duke synuar rritjen e të ardhurave. Rezultati më domethënës i politikave fiskale pasqyrohet në vlerat dhe në tendencat e deficitit buxhetor (shihni gjithashtu dhe buxheti, deficitit dhe suficiti buxhetor).

77. POLITIKA MONETARE.

Politika monetare i referohet atyre masave me anë të cilave bankat qendrore influencojnë mbi përqindjet e interesit në tregun e parasë, duke mundësuar kështu kontrollin e ofertës së parasë. Pjesa më e madhe e bankave qendrore, përfshirë edhe Bankën e Shqipërisë, përpiqen të manipulojnë ofertën e parasë, në mënyrë të tillë që të sigurojnë stabilitetin e çmimeve dhe të mundësojnë rritjen e ekonomisë në ritmet potenciale.

78. POLITIKË MONETARE E PAVARUR.

Politika monetare cilësohet e pavarur, kur banka qendrore e drejton atë në funksion të nevojave të vendit. Meqënëse ekziston një lidhje midis politikës monetare dhe kursit të këmbimit të monedhës së vendit, një politikë monetare mund të konsiderohet e pavarur vetëm nëse kursi i këmbimit është lënë të lëvizë lirisht. Nëse ekziston e kundërta, domethënë një raport këmbimi fiks midis monedhës kombëtare dhe një monedhe të huaj, atëherë banka qendrore, duhet që nga çasti që kursi i këmbimit ka ndryshuar, të blejë apo të shesë monedhë kombëtare. Me të tilla blerje ose shitje, ajo influencon mbi sasinë e monedhës së vendit. Kur ajo ble monedhë për të penguar një

mbiçmim të monedhës kombëtare, ajo rrit sasinë e monedhës kombëtare në dispozicion të bankave, në këtë mënyrë ato shohin likuiditetet e tyre të shtuara. Kur banka qendrore shet monedha të huaja për të shmangur nënçmimin e monedhës kombëtare, sasia e monedhës kombëtare pakësohet, likuiditetet tkurren. Një bankë qendrore e detyruar të mbrojë kursin e këmbimit, humb kontrollin e furnizimit me monedhë dhe kontrollin e nivelit të përqindjeve të interesit afatshkurtër. Politika e saj monetare është kopje e asaj të vendit, monedha e të cilit shërben si referim.

79. *PRODHIMI I
BRENDSHËM BRUTO -
PBB.*

Vlera totale në para, e mallrave dhe e shërbimeve të prodhuara në një vend në njësinë e kohës (zakonisht një vit) nga faktorët e prodhimit që ndodhen në atë vend, pavarësisht se kush i zotëron ato, përbën PBB-në e një vendi.

80. *PROGRAMI
MONETAR.*

Programi monetar luan një rol mjaft të rëndësishëm në procesin e hartimit dhe të zbatimit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Ai përfaqëson një plan të zhvillimit të treguesve monetarë, i cili mundëson përmbushjen e objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë, arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Ky program është në përputhje me strategjinë e zhvillimit ekonomik të vendit, duke inkuadruar: ruajtjen e një pozicioni të qëndrueshëm valutator të vendit dhe politikën fiskale të vendit. Në kuadër të regjimit të targetimit monetar, që Banka e Shqipërisë përdor për të kontrolluar inflacionin,

programi monetar saktëson objektivin e rritjes së ofertës monetare, kufirin e sipërm të ekspansionit të bazës monetare dhe nivelin e financimit të deficitit buxhetor nga sistemi bankar.

81. REPO.

Është marrëveshje riblerjeje me anë të së cilës Banka e Shqipërisë aktualisht manipulon ofertën e parasë. Në një kuptim më teknik, marrëveshja e riblerjes nënkupton një marrëdhënie huazimi (kreditimi në rastin e repos së anasjelltë) në themel të së cilës qëndron angazhimi i bankës qendrore (bankës tregtare) që, në përfundim të kohëzgjatjes së marrëveshjes, të kryejë një transaksion të kundërt: t'i kthejë bankës (Bankës së Shqipërisë) likuiditetin. Si garanci për këtë transaksion shërbejnë letrat me vlerë të qeverisë. Gjatë kohëzgjatjes së operacionit, banka qendrore merr nga bankat tregtare një kredi afatshkurtër në lekë, kredi për të cilën ajo paguan një interes të caktuar të llogaritur mbi përqindjen e repos. Kështu, nga një pikëpamje ekonomike, një repo i korrespondon një huaje të mbështetur në një garanci. Ajo është një nga instrumentet kryesore të politikës monetare të bankës qendrore, me anë të të cilës Banka e Shqipërisë administron likuiditetin në sistemin bankar.

82. REZERVA E DETYRUAR DHE PËRQINDJA E REZERVËS.

Shuma e parave dhe e aktiveve likuide, në lekë dhe në valutë, që bankat tregtare duhet të mbajnë në formën *cash* ose në formën e depozitës në Bankën e Shqipërisë. Zakonisht, kjo shumë është një përqindje e caktuar mbi totalin e depozitave pa dhe me afat, e cila në rastin e

Bankës së Shqipërisë është 10 për qind. Kjo e fundit zakonisht njihet me emrin përqindja e rezervës. Rezerva e detyruar ndaj depozitave pa dhe me afat në usd dhe në euro, mbahet në Bankën e Shqipërisë po në usd dhe në euro.

83. REZERVA VALUTORE.

Aktivitet në monedha të huaja dhe në ar në një bankë qendrore, në përgjithësi përbëjnë rezervën valutore. Investimet në valutë të Bankës së Shqipërisë dhe ari, përbëjnë rezervën valutore të saj, që ajo disponon dhe administron. Në pjesën më të madhe, rezerva valutore e Bankës së Shqipërisë, përfshin tituj të sigurtë në monedhë të huaj dhe në një pjesë më të vogël, depozita me afat fiks (depozita me afat) pranë bankave të vlerësuara si të sigurisë së lartë ose të rangut të parë. Në fund të vitit 2003, rezerva valutore e Bankës së Shqipërisë arriti të mbulojë rreth 4.7 muaj importe.

84. REGJIMET E POLITIKËS MONETARE.

Mënyra e vënies në zbatim të politikës monetare shpesh njihet me emrin regjim i politikës monetare. Në parim ekzistojnë tre regjime të politikës monetare: regjimi monetar, regjimi i kursit të këmbimit dhe regjimi i inflacionit të synuar. Zgjedhja e llojit të regjimit të mbajtjes së politikës monetare, para së gjithash, kushtëzohet nga ambienti ekonomik dhe nga natyra e mekanizmit të transmisionit që karakterizon çdo vend të veçantë. Për shkak se vende të ndryshme përballen me ambiente dhe me struktura të ndryshme ekonomike dhe financiare, është e kuptueshme se dhe ankorat e politikës monetare

85. REGJIMI I
INFLACIONIT TË SYNUAR
(INFLATION
TARGETING).

do të jenë të ndryshme në vende të ndryshme.
(shihni gjithashtu dhe objektivat e politikës
monetare)

Regjimi i inflacionit të synuar është një strategji e politikës monetare në themel të së cilës qëndrojnë pesë elemente kryesore: (1) deklarimi publik nga banka qendrore i nivelit të inflacionit të synuar në një horizont kohor afatmesëm; (2) angazhimi institucional i bankës qendrore për arritjen e stabilitetit të çmimeve si objektiv kryesor të politikës monetare. Krahasuar me këtë të fundit, objektivat e tjerë konsiderohen dytësorë; (3) strategjia për të përfshirë të gjithë variablat ekonomikë dhe financiarë që mendohet se ndikojnë inflacionin; (4) forcimi i pavarësisë dhe rritja e transparencës së bankës qendrore sidomos në shpegimin e procesit vendimmarrës nëpërmjet komunikimit të gjerë me publikun; (5) rritja e përgjegjshmërisë së bankës qendrore për arritjen e objektivit të inflacionit. Në kushtet e aplikimit të këtij regjimi rolin e objektivit të ndërmjetëm e luan vetë inflacioni i synuar në të ardhmen, fakt ky që justifikon dhe emrin e këtij regjimi.

86. REGJIMI I KURSIT TË
KËMBIMIT.

Regjimi i kursit të këmbimit është strategjia e politikës monetare, në themel të së cilës qëndron kontrolli i kursit të këmbimit të monedhës kombëtare si objektiv i ndërmjetëm. Më konkretisht, banka qendrore e vendit kontrollon çmimin e monedhës së saj, në varësi me lëvizjen që pëson monedha e huaj që ajo ka zgjedhur si ankorë në tregun ndërkombëtar duke ndërhyrë

në treg valutor, duke shitur dhe duke blerë valutë me fonde të rezervës së saj valutore. Ky regjim varion nga forma "e butë", ku fiksimi i monedhës nuk institucionalizohet, deri në formën "e fortë", e cila përfshin dhe zëvendësimin e plotë të monedhës vendase me monedhë të huaj për shembull, Euro. Kjo strategji ka përparësinë e sjelljes së inflacionit nën kontroll në një kohë relativisht të shkurtër, por në anën tjetër i heq politikës monetare fleksibilitetin për t'iu përgjigjur goditjeve të jashtme.

87. REGJIMI MONETAR.

Regjimi monetar është strategjia e politikës monetare në themel të së cilës qëndron përzgjedhja e treguesve monetarë (oferta e parasë) si objektiv i ndërmjetëm. Një rast i tillë është dhe politika monetare që ka ndjekur dhe ndjek edhe aktualisht Banka e Shqipërisë. Ky regjim është kritikuar shumë për efektivitetin e tij në zbatimin e politikës monetare, por suksesi i një strategjie të tillë nga ana e Zvicrës dhe e Gjermanisë, ka bërë që ai të bëhet pjesë përbërëse e strategjisë së Bankës Qendrore Evropiane. Gjithashtu, regjimi monetar ndihmon dhe në vendosjen dhe në ruajtjen e disiplinës së buxhetit. Kjo është dhe arsyeja pse Fondi Monetar Ndërkombëtar, në programet e tij të mbështetjes, imponon kushte për përqindjen e rritjes së parasë dhe të kredisë.

88. RREGULLI I TAYLOR-IT.

Rregulli i propozuar nga John B. Taylor i Stanford University (në nëntor 1992 në Konferencën Carnegie Rochester) për bankat qendrore në përcaktimin e normës së interesit, në mënyrë që

të arrijnë një inflacion të ulët pa shkaktuar luhatje të mëdha në prodhim dhe në punësim. Ai merr në konsideratë lidhjen midis inflacionit të pritshëm, rritjes së pritshme të PBB-së dhe normës së papunësisë. Më konkretisht ky rregull është: norma bazë e interesit = normën e inflacionit + 2 + 0.5(përqindja e shmangies së PBB-së reale nga prirja e PBB-së reale) + 0.5(norma e inflacionit - 2). Sipas rregullit të mësipërm norma bazë e interesit duhet të rritet në rast se inflacioni kalon objektivin 2 për qind ose kur PBB rritet mbi prirjen e saj afatgjatë. Kështu, në rast se inflacioni dhe rritja e PBB-së janë brenda objektivave atëherë norma e interesit të vendosur nga banka qendrore duhet të jetë 4 për qind.

89. RITJA EKONOMIKE.

Rritja ekonomike zakonisht matet si ndryshimi vjetor në përqindje i rritjes në njërin prej agregatëve madhorë të të ardhurave kombëtare, si për shembull, prodhimi i brendshëm bruto ose prodhimi i përgjithshëm kombëtar. Në çdo rast, kryhen korrigjime statistikore për të hequr efektet e inflacionit mbi çmimet, të cilat do të çonin në keqinterpretime.

90. SHITBLERJET ME TË DREJTA TË PLOTA.

Transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota, përfaqësojnë transferimin e plotë të të drejtës së pronësisë nga shitësi tek blerësi, duke mos përfshirë transaksionin e anasjelltë. Në rastin e Bankës së Shqipërisë transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota janë shitjet ose blerjet me të drejta të plota të letrave me vlerë. Këto operacione kanë efekt të përhershëm në tregun e parasë dhe

91. SHOQËRI
AKSIONERE.

nuk janë transaksione të kthyeshme. Përdoren vetëm si operacione me qëllim rregullimin e strukturës së tregut.

Shoqëri që formon dhe shton kapitalin e saj duke emetuar aksione. Aksionet formojnë kapitalin e shoqërisë aksionere. Çdo zotërues aksionesh, është bashkëpronar i shoqërisë.

92. SHPEJTËSIA E
PARASË.

Shpejtësia me të cilën paraqarkullon në ekonomi, përcaktohet si raport i të ardhurave (PBB-së) me ofertën e parasë.

93. SHUMËZUESI I
PARASË.

Shuma me të cilën depozita e re në sistemin bankar shumëfishohet si rezultat i përdorimit të saj në formën e kredisë, të ridepozitimit etj..

94. SISTEMI BANKAR.

Tërësia e të gjitha bankave plus dhe bankën qendrore të një vendi.

95. SISTEMI I REZERVËS
FEDERALE.

Banka Qendrore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky institucion ka si përgjegjësi themelore hartimin dhe zbatimin e politikës monetare në SHBA.

96. STABILITETI I
ÇMIMEVE.

Stabiliteti i çmimeve përkon me një situatë ku niveli i çmimeve mbetet i pandryshuar ose ndryshon pak. Në përgjithësi, pranohet që stabiliteti i çmimeve është në përputhje me shkallën e zhvillimit ekonomik të vendit. Kështu, për ekonominë e Eurozonës stabiliteti i çmimeve identifikohet me një normë vjetore inflacioni nën vlerën 2 për qind. Shqipëria, që prej vitit 1999,

97. STABILITETI
MONETAR.

ka regjistruar shifra të ulëta të inflacionit, duke synuar drejt intervalit 2-4 për qind. Në këto kushte, është vlerësuar se kontrolli i Bankës së Shqipërisë mbi stabilitetin e çmimeve është arritur në mënyrë efikase, nëpërmjet zbatimit të një politike monetare të kujdesshme.

Shihni stabiliteti i çmimeve.

98. TRAFIKU I PAGESAVE.

Trafiku i pagesave nënkupton të gjitha pagesat monetare si ato në formë *cash*-i ashtu edhe ato me kalim në llogari (nëpërmjet transferimeve nga një llogari në tjetrën) dhe ato elektronike.

99. TREGU I KAPITALEVE.

Tregu në të cilin negociohen kapitale me afat maturimi më tepër se 12 muaj. Fondet me afat maturimi më të shkurtër tregtohen në tregun e parasë. Tregu i kapitaleve shërben kryesisht për të investuar dhe për të financuar shpenzimet kapitale.

100. TREGU I PARASË.

Treg në të cilin janë vendosur fonde që jepen hua afatshkurtër, zakonisht nga një ditë deri 12 muaj. Kur afatet janë më të gjata atëherë fondet tregtohen në tregun e kapitaleve. Tregu i parasë, para së gjithash, shërben për të ekuilibruar ofertën e likuiditeteve midis bankave. Banka qendrore dhe bankat tregtare janë zakonisht operatorët kryesorë të tregut të parasë.

101. YIELD-I, KURBA E
YIELD-IT

Përqindja vjetore në kthim nga një investim, e shprehur në përqindje. Ndërkohë, kurba e *yield*-

it tregon lidhjen ndërmjet *yield*-eve dhe datave të maturimit për një grup obligacionesh, zakonisht për obligacione të qeverisë, në një moment të caktuar.



Botime të përgatitura me rastin e Konferencës III, Tiranë 5 - 6 dhjetor 2003 "Banka e Shqipërisë në dekadën e dytë të tranzicionit".

"Departamentet e Bankës së Shqipërisë"

Fletëpalosje:

"Teknologjia e Informacionit" (shqip dhe anglisht)

"Burimet Njerëzore" (shqip dhe anglisht)

"Mbikëqyrja Bankare" (shqip dhe anglisht)

në Bankën e Shqipërisë.

Broshurë

"Pak fjalë për Bankën Qendrore"



Botime të përgatitura me rastin e Konferencës IV, Sarandë 11-12 shtator 2003 "Ekonomia shqiptare: Ecuria dhe sfidat e politikave ekonomike".

Fletëpalosje

"Sistemi i Pagesave" (shqip dhe anglisht)

Broshurë

"Historia e Akullores"

"Inflacioni: Çfarë duhet të dimë për të?"

"Të flasim thjesht për inflacionin"

"Banka Qendrore Evropiane"

"Instrumentet e Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë dhe procedurat për realizimin e tyre"

(shqip dhe anglisht)

"Sistemi i Pagesave"

Shqipëroi dhe përgatiti për botim
E. Çeliku dhe G. Kolasi,
Të gjithë të drejtat i takojnë Bankës së Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel: (355) 4 222230; 235568; 235569.
Faks: (355) 4 223558.
e-mail: public@bankofalbania.org
<http://www.bankofalbania.org>

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi: 5000 kopje.